



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRAK LIPLJAN

**P.nr.509/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të akuzuarit F.P. nga fsh. S. K.L., të cilin e akuzon e PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.3506/2016 të dt.05.07.2016, për shkak të veprës penale, Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.07.02.2017, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Fatmire Cacaj, dhe të akuzuarit, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpall këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të akuzuarit:

**F. P.**, nga i ati N., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në fsh. S. K. L., shqiptarë, shtetas i R. së Kosovës, me nr. personal *numër personal...*, më parë i padenuar, mbrohet ne liri.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Me datën 19.02.2016, në fshatin S., në shtëpinë e të pandehurit, punëtorët e autorizuar të KEDS-it, kanë konstatuar se i pandehuri, me qëllim që vetit ti sjell pasuri të kundërligjshme, në njehsorin elektrik nr....., ka kyqur një kabëll në mënyrë ilegale, me çrast ka bërë të pamundur matjen e energjisë elektrike, me çrast të dëmtuarës K.i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 7, 21, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 320 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin, e

**G J Y K O N**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) muaji**, dhe me dënim me gjobë në shumë prej **200-€**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në afat prej 1(një) viti nuk kryen veprën tjetër penale.

**E dëmtuara K.**-Departamenti ligjor në F. udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt gjyqësore.

**DETYROHET** i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 20 euro, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.3506/2016 të dt.05.07.2016, e ka akuzuar të pandehurin F. P. nga fsh. S., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe ka shtuar se në mungesë të njehsorit elektrik përkohësisht e ka vendosur një kabëll, dhe njëherit ka theksuar se është pagues i rregullt i energjisë elektrike.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit, për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i pandehuri është mbajtës i familjes, sjelljen e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.**

**P.nr. 509/16 dt. 07.02.2017**

**Sekretarja juridike**  
**Nexhmije Ahmeti**

**GJYQTARI**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.